



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 31, datë 25.02.2021

**PËR
MIRATIMIN E AGJENTËVE NË SIGURIME, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË
SHOQËRISË SË SIGURIMIT “ALBSIG” SH.A**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të Rregullores nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e zj. Justina Goxhaj, zj. Mirjanda Batusha dhe z. Denis Hallaçi, për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime, në klasat e Jo-Jetës, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit “Albsig” sh.a.**
- 2. Ngarkohet Drejtorja e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ANËTAR
Deniz DERALLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE**